

Besnik Tahiri: Garancitë juridike për shërbimin civil, një betejë që vazhdon



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHTIM PAS DËSHTIMI, TENTATIVA E RADHËS TË ENJTEN



Për të tetën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar ta konstitujnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. E

propozuara për kryeparlamentare nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, nuk po i merr votat e nevojshme. Ajo të martën mori 54 vota për, tri vota më

pak se herëve të tjera. Seanca konstituive do të vazhdojë të enjten në orën 10:00. Njohësit e proceseve politike thonë se zgjedhjet duhet të jenë zgjidhja e fundit

AKTUALE



PRESIDENTI I MALIT TË ZI S'E DEKRETON MARRËVESHJEN PËR PLAZHIN E MADH NË ULQIN F. 2

RAPORTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT: AI PËRMEND LIGJET QË S'I KALOI KUVENDI I KOSOVËS F. 7

KURTI BËRI HOMAZHE NË ZHAZHË DHE VIZITOI KOMPLEKSIN E KULLAVE TË ISA BOLETINIT F. 7

EKONOMI



FERAT SHALA: KURTI I NDAU QYTETARËT E KOSOVËS NË DY TREGJE ENERGJETIKE, KJO ËSHTË E KUNDËRLIGJSHME F. 8

NISIN PUNIMET PËR MODERNIZIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA B F. 8

SPORT



'YLLI I JAVËS', THAQI: SHPRESOJMË TË DALIM NË EVROPË F. 10

ÇMIMI I RRYMËS PËR BIZNESET PRITET TË RRITET DERI NË 30 PËR QIND F. 5



KOS: NORMALIZIMI ME SERBINË, PARAKUSHT PËR PROCESIN E ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË BE F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Presidenti i Malit të Zi s’e dekreton marrëveshjen për Plazhin e Madh në Ulqin

PODGORICË, 29 PRILL - Presidenti i Malit të Zi, Jakov Millatoviq, ia ka kthyer Kuvendit për rishqyrtim njërën nga dy marrëveshjet që Qeveria e Malit të Zi i kishte nënshkruar me Emiratet e Bashkuara Arabe - atë që i hapte rrugë dhënies me qira të Plazhit të Madh në Ulqin. Sipas asaj marrëveshjeje, Mali i Zi do t’ia jepte Plazhin e Madh me qira për 99 vjet kompanisë “Emmar” të biznesmenit arab Mohamed Alabbarit, që do të ndërtonte një kompleks megaturistik në Ulqin. Alabbar ka marrë pjesë edhe në projekte rajonale në Kroaci, Shqipëri dhe në “Beogradin mbi ujë” në Serbi. Por, Millatoviq, i



cili dekretoi Ligjin për Bashkëpunim Ekonomik, nuk e Ratifikimin e Marrëveshjes për bëri të njëjtën edhe për Ligjin

për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim në Fushën e Turizmit dhe Zhvillimit të Pasurive të Paluajtshme. Këtë të fundit ai ua ktheu deputetëve për ta votuar sërish. Që marrëveshjet e nënshkruara nga kryeministri Millojko Spajiq në fund të marsit me zyrtarët e Emirateve të hyjnë në fuqi, Kuvendi i Malit të Zi i miratoi dy ligje me procedurë të përspejtuar më 23 prill, me propozim të qeverisë. Ato u mbështetën nga deputetët e shumicës parlamentare - lëvizja e Spajiqit “Evropa tani”, partia “Demokracia e Re Serbe” e kryetarit të Kuvendit, Andrija Mandiq, Demokratët dhe Partia

Boshnjake. Ditëve para miratimit, Millatoviq dhe një pjesë e sektorit joqeveritar paralajmëruan se me miratimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim në Turizëm dhe Zhvillim të Pasurive të Paluajtshme po pezullohet Kushtetuta dhe një pjesë e ligjeve të Malit të Zi. Kthimi i këtij ligji nga Millatoviq e detyron Kuvendin të votojë sërish për të. Nëse ligji miratohet përsëri, ai do t’i dërgohet sërish Millatoviqit për nënshkrim. Sipas Kushtetutës, në atë rast ai është i detyruar ta nënshkruajë, dhe ligji hyn në fuqi.

Kremlini refuzon ofertën e Zelenskyt për armëpushim 30-ditor

MOSKË, 29 PRILL - Kremlini refuzoi thirrjen e presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky për një armëpushim 30-ditor, pasi udhëheqësi i Ukrainës kritikoi propozimin e presidentit rus, Vladimir Putin, për një ndalesë treditore të luftës në Ukrainë që përkonte me festimet vjetore të Ditës së Fitores në Moskë. Armëpushimi i propozuar nga Rusia do të ndodhte nga 8 deri më 10 maj, kur Rusia shënon 80-vjetorin e fitores kundër Gjermanisë naziste në Luftën e Dytë Botërore. Zelensky vuri në dyshim nevojën për të pritur deri atëherë për një armëpushim, duke thënë se kjo ishte një lëvizje “vetëm për t’i siguruar Putinit heshtje për paradën e tij”. “Ne vlerësojmë jetët njerëzore, jo paradat”, tha Zelensky në

adresimin e tij të përnatshëm, duke propozuar një armëpushim “të menjëhershëm, të plotë dhe të pakushtëzuar” për 30 ditë. Një propozim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për një armëpushim të pakushtëzuar, me të cilin Ukraina ishte pajtuar, gjithashtu mbetet opsion, përsëriti Zelensky. “Rusia e di saktësisht se çfarë duhet të bëjë dhe si të përgjigjet: të ndalojë singërisht sulmet”, tha ai. Ministri i Jashtëm i Ukrainës tha më herët se njoftimi i Kremlinit më 28 prill ishte i pasinqertë dhe se armëpushimi duhej të fillonte menjëherë. Përgjigja e Rusisë më 29 prill, megjithatë, ishte refuzimi i armëpushimit më të gjatë “të menjëhershëm”, me zëdhënësin e Kremlinit, Dmitry



Peskov, që tha se disa çështje duhej të zgjidheshin më parë. “Pa përgjigje për këto pyetje, është e vështirë të hyhet në një armëpushim afatgjatë”, tha ai. Putini ka deklaruar më parë,

gjatë negociatave mbi propozimin amerikan, se plani duhet të përmbante klauzola që ia ndalojnë Ukrainës ta përdorë pauzën për t’u riorganizuar dhe për t’u

armatosur, si dhe ndalimin e furnizimeve me armë nga Perëndimi për Kievin. Ai nuk ofroi asnjë kompromis nga ana e Rusisë në këmbim. Kjo është hera e dytë këtë muaj që Kremlini bën thirrje për ndalim të luftimeve. Një propozim për pushimet e Pashkëve në fillim të këtij muaji u injorua gjerësisht, ndërsa Rusia dhe Ukraina vazhduan ta godasin njëra-tjetrën. Ashtu si çdo vit gjatë presidencës së tij, Putini do të drejtojë një paradë ushtarake në Sheshin e Kuq më 9 maj, për Ditën e Fitores, duke festuar rolin sovjetik në mposhtjen e Gjermanisë. Në vitet e fundit ai ka shfrytëzuar këtë rast për ta lavdëruar historinë sovjetike dhe ruse, ndërsa kritikon Perëndimin.

OKB: Mbi 72 000 migrantë të vdekur ose të zhdukur në dekadën e fundit

NJU-JORK, 29 PRILL - Më shumë se 72 000 vdekje dhe zhdukje janë dokumentuar përgjatë rrugëve të migrimit në mbarë botën gjatë dekadës së fundit, shumica në vende të prekura nga kriza, tha të martën Organizata e Kombeve të Bashkuara. Viti i kaluar shënoi numrin më të lartë të regjistruar ndonjëherë të migrantëve të vdekur, me të paktën 8 938 persona që humbën jetën përgjatë rrugëve të migrimit, sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). “Këto shifra janë një kujtesë tragjike se njerëzit rrezikojnë jetën kur pasiguria, mungesa e mundësive dhe presione të tjera i lënë pa zgjedhje të sigurt apo të qëndrueshme në vendin e tyre”,

tha drejtoresha e IOM-it, Amy Pope. Raporti i agjencisë së OKB-së zbuloi se gati tri të katërtat e të gjitha vdekjeve dhe zhdukjeve të migrantëve të regjistruara globalisht që nga viti 2014 ndodhën ndërsa njerëzit po iknin nga pasiguria, konfliktet, katastrofat dhe krizat e tjera humanitare. Një në katër ishin “nga vende të prekura nga kriza humanitare, me mijëra vdekje të afganëve, rohingjave dhe sirianëve të dokumentuara përgjatë rrugëve të migrimit në mbarë botën”, thuhej në Raportin për Migrantët e Zhdukur të IOM-it. Raporti thekson se më shumë se 52 000 persona humbën jetën derisa përpiqeshin të



largoheshin nga një prej 40 vendeve në botë ku OKB-ja ka një plan reagimi ndaj krizave ose plan humanitar të veprimit. Pope bëri thirrje për investime ndërkombëtare “për të krijuar stabilitet dhe mundësi brenda komuniteteve, në mënyrë që migrimi të jetë një zgjedhje, jo një domosdoshmëri”. “Dhe kur qëndrimi [në vendlindje] nuk

është më i mundur, duhet të punojmë së bashku për të mundësuar rrugë të sigurt, ligjore dhe të rregullta që mbrojnë jetët”, tha ajo. Mesdheu Qendror mbetet rruga më vdekjeprurëse e migrimit në botë, me gati 25 000 persona të humbur në det gjatë dekadës së fundit, tha IOM. Më shumë se 12 000 prej tyre janë humbur në det pasi janë nisur nga Libia e shkatërruar nga lufta, ndërsa të panumërt të tjerë janë zhdukur gjatë tranzitit nëpër shkretëtirën e Saharasë, sipas raportit. Më shumë se 5 000 persona kanë humbur jetën derisa përpiqeshin të largoheshin nga Afganistani i shkatërruar nga kriza gjatë dekadës së fundit,

shumë prej tyre pas rikthimit të talibanëve në pushtet në vitin 2021. Dhe më shumë se 3 100 anëtarë të pakicës së përndjekur Rohingya nga Mianmari kanë vdekur gjatë kësaj periudhe, shumë prej tyre në mbytje anijesh apo gjatë kalimit në Bangladesh. “Shumë shpesh, migrantët harrohen”, paralajmëroi Julia Black, koordinatore e Projektit për Migrantët e Zhdukur të IOM-it dhe autore e raportit. “Dhe për shkak të mungesës së të dhënave - sidomos në zonat e luftës dhe në rajonet e goditura nga katastrofat - numri real i viktimave ka shumë gjasa të jetë shumë më i lartë sesa kemi regjistruar”, tha ajo.

KOS: NORMALIZIMI ME SERBINË, PARAKUSHT PËR PROCESIN E ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË BE

PRISHTINË, 29 PRILL - Komisionarja e Bashkimit Evropian për Zgjerim, Marta Kos, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se normalizimi i marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë është parakusht që Kosova të mund ta marrë statusin e vendit kandidat dhe ta nisë procesin e anëtarësimit në BE.

Kosova aplikoi për anëtarësim në BE më 15 dhjetor të vitit 2022, e tani ajo mbetet vendi i vetëm në rajon që nuk e ka ende statusin e vendit kandidat. “Ne po presim për [formimin e] qeverisë së re. Jam në kontakt me politikanët atje, dhe ata pretendojnë se janë shumë në favor të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, çka është parakusht që të mund të nisë procesi i negociatave ose të jepet statusi i kandidatit”, tha Kos në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”.

Ajo tha se është shumë e rëndësishme që qeveria e ardhshme e Kosovës t'i plotësojë disa parakushte “që duhet të përmbushen”, pa përmendur se cilat janë ato. Kosova po udhëhiqet nga një qeveri në detyrë pasi që legjislatura e re ende nuk është konstituuar, as më shumë se një muaj pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare që ishin mbajtur më 9 shkurt.

Procesi i anëtarësimit të një vendi në BE merr kohë, pasi vendi kandidat duhet t'i përmbushë disa kritere, t'i përshatë ligjet e veta me ato të BE-së, si dhe ta presë ratifikimin e traktatit për anëtarësim në parlamentet e secilit vend anëtar të BE-së.

Kosova ende është në fazat fillestare të anëtarësimit, pasi ende nuk ka marrë statusin e vendit kandidat. Për këtë gjë, fillimisht Komisioni Evropian duhet ta japë pëlqimin për aplikimin për anëtarësim e pastaj Këshilli Evropian duhet



ta konfirmojë unanimisht statusin si vend kandidat. “Nuk kam marrë asnjë sinjal nga shtetet anëtare ose nga presidenca daneze [e Këshillit Evropian] se kjo gjë [marrja e statusit gjatë presidencës daneze] mund të ndodhë. Por, mendoj se do të ishte shumë mirë të nisim”, tha ajo.

Edhe më parë këtë muaj shefja e politikës së jashtme e bllokut evropian, Kaja Kallas, kishte thënë se as Kosova e as Serbia nuk mund të ecin përpara në rrugën drejt BE-së pa normalizim të marrëdhënieve.

Me ndërmjetësimin e BE-së, në vitin 2023 Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve. Por, prej atëherë, blloku i ka kritikuar të dy vendet se nuk e kanë zbatuar marrëveshjen pavarësisht se ajo është e detyrueshme për to.

Për shkak të krizave në veriun e Kosovës, që rritën tensionet mes dy vendeve, që nga shtatori i vitit 2023 në Bruksel

nuk është zhvilluar asnjë raund i dialogut politik, por ka pasur vetëm bisedime në nivel të kryenegociatorëve.

Pikërisht këto tensione në veriun e Kosovës kishin bërë që BE-ja më 2023 t'i vendosë disa masa ndëshkuese Kosovës dhe vazhdon t'i mbajë ato në fuqi me arsyetimin se Kosova nuk ka bërë ende mjaftueshëm për shtensionimin e gjendjes në veriun e banuar me shumicë serbe.

Me gjithë kërkesat e liderëve të Kosovës për heqjen e këtyre masave, Kos theksoi se aktualisht jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë të gatshme për heqjen e masave në këtë fazë. “Ne ende nuk e dimë. Jemi duke diskutuar këtë. Nëse shtetet anëtare do të jenë për heqjen e tyre, sigurisht se do ta bëjmë këtë. Por, për momentin, jo të gjitha shtetet anëtare janë për heqjen e masave”, u shpreh ajo.

Gjatë intervistës së dhënë për REL-in, Kos tha se ajo do ta

cilësonte si një dështim nëse gjatë mandatit të komisionit aktual nuk do të kishte anëtarë të rinj në Bashkimin Evropian. Megjithatë, ajo shprehu optimizëm, duke theksuar se nga pikëpamja teknike “mund të përfundojmë me Malin e Zi [si anëtar] deri në fund të vitit 2026” dhe “mund të përfundojmë me Shqipërinë [si anëtar] deri në fund të vitit 2027”.

E pyetur nëse Mali i Zi dhe Shqipëria do të bëhen anëtarë të 28 dhe 29 të BE-së, ajo u përgjigj se mund të ketë edhe vende të reja.

Duke folur për Serbinë, vendin që ajo do ta vizitojë këtë javë, Kos tha se “Serbia duhet vërtet të japë rezultate”. “Fjalët nuk mjaftojnë. E shoh misionin tim ose vizitën time atje si një përpjekje të madhe për ta rikthyer Serbinë në rrugën evropiane”, tha Kos.

Ajo shtoi se kërkesat e protestuesve, të cilët po protestojnë prej muajsh në Serbi - pas vdekjes së 16 personave nga rrëzimi i një

strehe betoni në stacionin e trenave në Novi Sad - janë të njëjta me ato të Komisionit Evropian. “Është shteti i së drejtës, është lufta kundër korrupsionit, është prokurimi publik, është legjislacioni për mediet, është legjislacioni për zgjedhjet. Serbia ka premtuar shumë në dhjetor në të ashtuquajturin 'non-paper' [dokument joformal], tha Kos, duke shtuar se tani “duhet të kontrollojmë nëse po i zbaton ato që i ka premtuar”. “Dhe, në fakt, më pëlqen të them që unë jam mbështetësja më e madhe e protestuesve, sepse nëse Serbia është serioze për rrugën drejt BE-së - dhe ata më thonë se janë - atëherë duhet të japin rezultate”, tha Kos.

Ndërkohë zyrtarja e BE-së tha se është e vështirë të punohet me liderë si presidenti i entitetit të Republikës Sërpska (RS) në Bosnjë-Hercegovinë, Millorad Dodik. Ajo tha se “është e vështirë të merresh me dikë që nuk vepron në të mirën e vendit të tij, Bosnjë-Hercegovinës” dhe që shkon “kundër integritetit territorial, sovranitetit dhe rendit kushtetues”.

Më tutje, Kos theksoi se kjo është një nga arsyet pse Bosnjë-Hercegovina, edhe pse ka status kandidatit, ende nuk i ka hapur negociatat me BE-në.

Në lidhje me sanksionet potenciale ndaj Dodikut, ajo shtoi se “shtetet anëtare nuk janë të bashkuara” për t'i vendosur ato.

Dodiku, së bashku me kryetarin e Parlamentit të RS-së, Nenad Stevandiç, dhe kryeministrin Radovan Vishković, akuzohen për sulm ndaj rendit kushtetues, dhe ndaj tyre është lëshuar një fletarrestim qendror në Bosnjë-Hercegovinë, pasi nuk i janë përgjigjur thirrjes së Prokurorisë së Bosnjës për t'u paraqitur për marrje në pyetje.

Paraqitet raporti fillestar i projektit 58 milionësh për ndërtimin e digës së Pollatës

PRISHTINË, 29 PRILL - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka marrë pjesë të martën në një takim që është mbajtur në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në të cilën është prezantuar raporti fillestar i projektit për ndërtimin e Digës së Pollatës. Në këtë takim ishin ministri në detyrë, Liburn Aliu, zëvendësministri Jeton Raka dhe zyrtarë të tjerë.

Kryetari Bulliqi tha se, sipas raportit fillestar të hartuar nga kompania e kontraktuar nga MMPHI-ja, kjo digë do të ketë kapacitet të përgjithshëm prej mbi 11 milionë m³ ujë, nga të cilat mbi 9.8 milionë m³ do të jenë ujë i dobishëm për furnizim. “Projekti parasheh tre skenarë furnizimi me ujë, që në varësi të ndarjes nga sistemi i Batllavës, mund të furnizojë deri në 117,497 banorë me 314 l/s. Ky është

një investim jetik që garanton furnizim të qëndrueshëm me ujë për mijëra qytetarë dhe zhvillim të qëndrueshëm për rajonin e Llapit”, ka theksuar Bulliqi.

Ndërkohë, ministri në detyrë, Liburn Aliu, tha se me një vlerë rreth 58 milionë euro, kjo digë pritet ta lehtësojë ndjeshëm mungesën e ujit, sidomos tani kur thatësia po bëhet më e shpeshtë si pasojë e ndryshimeve klimatike globale.





DËSHTIM PAS DËSHTIMI, TENTATIVA E RADHËS TË ENJTEN

Për të tetën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. E propozuara për kryeparlamentare nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, nuk po i merr votat e nevojshme. Ajo të martën mori 54 vota për, tri vota më pak se herëve të tjera. Seanca konstituive do të vazhdojë të enjten në orën 10:00. Njohësit e proceseve politike thonë se zgjedhjet duhet të jenë zgjidhja e fundit

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 29 PRILL - Tetë herë u mbledhën, por çdoherë dështuan ta çojnë në fund konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Deputetët e rinj nuk po arrijnë të gjejnë mirëkuptim për votimin e kryetarit të ri të Kuvendit. E propozuara për kryeparlamentare nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, nuk po i merr votat e nevojshme. Kësaj radhe ajo mori 54 vota për, 44 kundër dhe 3 abstenuan. Në seancat paraprake për të kishin votuar 57 deputetë, por kësaj radhe tre deputetë munguan, një nga LV-ja dhe dy nga minoritetet. Seanca konstituive ka nisur më 15 prill dhe në shtatë seancat paraprake deputetët kanë arritur të kalojnë vetëm dy pikat e para të rendit të ditës - miratimin e raportit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe Betimin e Deputetëve, por kanë ngecur në pikën e tretë,

atë të zgjedhjes së kreut të ri të organit legjislativ. Pas përfundimit të seancës, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, tha se si kompromis kanë ofruar që partia e tij, së bashku me Partinë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës, të pajtohen që të votohen në paketën kryeparlamentare dhe tri nënkryetarët. "Ajo që kemi ofruar si kompromis është një dakordim politik, një konsensus politik që të tri partitë më të mëdha, që u takon të propozojnë kandidatë për nënkryetarë, përveç përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në Kuvend, të mblidhen, të dakordohen [të votohen] në paketë emri i kandidatës për kryeparlamentare Albulena Haxhiu si dhe emrat e nënkryetarëve, në mënyrë që të vazhdohet tutje dhe të kemi dakordim që t'i votojmë", tha ai. Murati hodhi poshtë akuzat e

partive se LV-ja po kërkon që Haxhiu "të votohet me zor", duke shtuar se disa deputetë të partive, që legjislacionin e kaluar ishin në opozitë, kanë shprehur "dëshirë që të dalin nga kjo situatë", por shtoi se partitë e tyre nuk kanë ndryshuar qëndrim, andaj ata nuk po mund të votojnë për Haxhiun. LV-ja, përsëriti ai, nuk është e interesuar për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, por është e gatshme për votime të reja, nëse ky mbetet opsioni i vetëm për daljen nga situata e krijuar. Ndërkaq, kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, tha se LV-ja ka "mentalitet të imponimit", pasi që kjo parti ka të drejtë ta propozojë kryeparlamentarin, por jo të imponojë se si votojnë të zgjedhurit e popullit. Ai akuzoi LV-në se "me qëllim po mban të bllokuar" procesin e krijimit të institucioneve të reja, teksa shtoi se kishte tri mesazhe për partinë fituese të zgjedhjeve. "E para,

demokracia funksionon me shumicë e jo me imponim. E dyta, institucionet janë të popullit, nuk janë të asnjë partie politike të veçantë. Dhe, e treta, duhet ta kuptojnë të gjithë se koha e sundimit njëpartiak dhe e monizmit ka përfunduar. Sa më parë që t'i kuptojë LV-ja këto tri çështje, aq më mirë për vendin", tha Krasniqi.

Shefja e grupit parlamentar e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, tha se insistimi i LV-së për ta propozuar Haxhiun për pozitën e kryeparlamentares e ka shndërruar Kuvendin "në një cirk". "LDK-ja është për gjetjen e një zgjidhjeje kushtetuese që respekton Kushtetutën dhe rezultatin e zgjedhjeve. Ne e njohim të drejtën e të parit për të propozuar, por kjo nuk do të thotë se ne e barmim votën te një subjekt duke votuar sipas kërkesave të tyre", tha ajo, duke shtuar se përgjegjësia për këtë situatë bie mbi partinë e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti.

Ndërkaq para nisjes së seancës, kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se LV-ja nuk do të marrë votën e partisë nëse insiston në kandidimin e Haxhiut. "Nëse ndryshohet kandidati [për kryeparlamentar] sot do të votohet. Por, si duket, do të

jemi në situatë të njëjtë", tha ai për gazetarët para nisjes së seancës.

Në anën tjetër, kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, tha se i takon LV-së të bëjë përpjekje maksimale për të formuar një shumicë parlamentare. "Shumica parlamentare nënkupton koalicion qeverisës edhe për Kuvend dhe qeveri, kështu ka ndodhur edhe herën e kaluar", tha ai. Nisma, sipas Limajt, do të kontribuojë që të evitohen zgjedhjet e reja, "por jo me çdo kusht". "Nëse nuk ka zgjidhje, ka zgjidhje tjetër. Ato janë zgjedhjet", tha ai para nisjes së seancës.

10 opsionet e Naim Rashitit për dalje nga kriza politike

Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, ka thënë se zgjedhjet duhet të jenë zgjidhja e fundit. Ai në "Facebook" ka dhënë dhjetë opsione për dalje nga kriza politike. Opsionet e tij: "1. LV duhet të propozojë tre kandidatë për kryetar/e të kuvendit. Deputetët (së paku pjesa më e madhe e tyre) do të votojnë njërin prej tyre. 2. Një grup i deputetëve duhet me urgjencë të dërgojnë një pyetje

ÇMIMI I RRYMËS PËR BIZNESET PRITET TË RRYTET DERI NË 30 PËR QIND

PRISHTINË, 29 PRILL - Deri në 30 për qind pritet të shtrenjtohet çmimi i energjisë për bizneset e mëdha, paralajmërojnë përfaqësues të disa kompanive të licencuara për furnizimin me energji elektrike në Kosovë. Këto kompani aktualisht kanë shtuar përpjekjet për sigurimin e energjisë në prag të nisjes së procesit të liberalizimit të tregut të energjisë.

Çfarë do të thotë liberalizimi i tregut të energjisë?

Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë në vendet e Bashkimit Evropian ka filluar në fund të viteve '90 me qëllim rritjen e konkurrencës, efikasitetit, sigurisë dhe zgjedhjes për konsumatorët, ndërsa në Ballkanin Perëndimor ky proces është ende në zhvillim.

Në Kosovë liberalizimi i tregut të energjisë është paraparë me Ligjin për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2017, por zbatimi i tij është shtyrë për shkak të rrethanave të ndryshme.

Tashmë Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka marrë vendim që nga data 1 qershor të gjitha kompanitë e mëdha - konkretisht ato me mbi 50 të punësuar ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro - të kalojnë në tregun e hapur të energjisë. Sipas ZRRE-së, numri i tyre është mbi 1 000.

Aktualisht këto biznese furnizohen nga Operatori për Furnizim me Energji (KESCO), si furnizuesi kryesor i licencuar për energji me çmime të rregulluara nga ZRRE-ja.

Ndërsa nga 1 qershori kompanitë e mëdha duhet ta zgjedhin vetë furnizuesin e tyre me çmime të parregulluara, të cilat përcaktohen nga kërkesa dhe oferta në treg. Aktualisht në tregun e lirë të Kosovës janë të licencuara 18 kompani që ofrojnë furnizim me energji elektrike, shumica prej të cilave janë nga Kosova, por ka edhe kompani nga rajoni.

Disa prej tyre kanë nisur negociatat me prodhues të energjisë në rajon për t'i siguruar kapacitetet e nevojshme për furnizimin e klientëve të rinj.

Ndërkohë, disa biznese, si "Frutex" në Suharekë, po kërkojnë kompani vendore për të negociuar çmimin për rrymën.



Bizneset përballë zgjedhjes së furnizuesve të rinj

Drilon Brahimi, drejtor i përgjithshëm i kompanisë "Tredint Group L.L.C", e cila u licencua për furnizim me energji elektrike në fund të vitit të kaluar, thotë se janë në fazën e hulumtimit të tregut për të siguruar çmime më të volitshme, por ende nuk kanë nënshkruar asnjë kontratë me kompani prodhuese nga rajoni. "Shumë kompani vendore, konkretisht ato prodhuese, kanë filluar të na dërgojnë profilin vjetor të konsumit energjetik dhe po kërkojnë informacione rreth çmimit. Ne jemi në fazën e përgatitjes së ofertave. Përgjigjja konkrete për secilën pritje t'iu dërgohet në fillim të majit", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Megjithatë, Brahimi thekson se çmimi për muajt e parë pritjet të jetë deri në 30 për qind më i lartë se tarifatat aktuale të energjisë.

Aktualisht për konsumatorët e amvisërisë dhe ata komercialë që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 13.29 centësh.

Nga 1 maji hyjnë në fuqi tarifat e reja, me një rritje prej 16.1-

përqindësh, por ato nuk do të zbatohen për bizneset me mbi 50 punëtorë.

Rritjen prej 30-përqindësh për kompanitë e mëdha e paralajmëron edhe Diamant Dalladaku nga kompania "Enerco LLC". Edhe ai thotë se ende nuk ka nënshkruar ndonjë kontratë me kompani të huaja dhe se janë në proces të hulumtimit të tregut. "Liberalizimi i tregut të energjisë është një proces i ri dhe gjatë zbatimit po paraqiten sfida. Si problem në kohën e përgatitjes është mungesa e informacioneve për energjinë që shpenzojnë bizneset, të cilat po dalin në tregun e hapur", thotë Dalladaku për "Radion Evropa e Lirë".

Në raportin vjetor të ZRRE-së thuhet se vitin e kaluar mbi 5 400 gigavatë në orë (GWh) ka qenë sasia e përgjithshme e energjisë së shitur te të gjithë konsumatorët në Kosovë. Nga kjo sasi, 3 156 GWh apo 58.4 për qind janë shpenzuar nga konsumatorët familjarë, kurse pjesa tjetër, 2 041 apo mbi 37 për qind, është shpenzuar nga konsumatorët jofamiljarë dhe në këtë kategori përfshihen të gjitha bizneset.

Palushi: Ende nuk kemi oferta konkrete për energjinë

Kompania për prodhimin e lëngjeve "Frutex" në Suharekë është një nga kompanitë që nga

qershori do ta gjejë vetë kompaninë furnizuese për rrymë.

Pronari i saj, Shaqir Palushi, thotë se kanë dërguar kërkesë për takim në të gjitha kompanitë e licencuara për furnizim me energji, në mënyrë që të negociojnë për çmimin. Megjithatë, Palushi ende nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga to. "Po pres në ditët në vazhdim... por, nuk besoj se ato janë të përgatitura për këtë proces, sidomos në kushtet e turbulencës që kanë mbizotëruar vitet e fundit lidhur me çmimet e energjisë elektrike", thekson ai.

Palushi tregon se për një muaj shpenzon energji në vlerë deri në 40 mijë euro. Në rast të rritjes së çmimit për 30 për qind, për sasinë e njëjtë të shpenzuar ai do të paguajë mbi 52 mijë euro. "Sigurisht se kjo do t'i rrisë shpenzimet operative, por ne do të bëjmë përpjekje që fillimisht të ketë ndikim në uljen e profitit të kompanisë dhe jo t'i rrisim çmimet", thotë ai.

Kompanitë e licencuara, të përgatitura?

Odat ekonomike në Kosovë kanë kërkuar shtyrjen e këtij vendimi pasi, sipas tyre, edhe pse kompanitë janë të licencuara, shumica prej tyre nuk kanë pasur klientë fundorë dhe kanë ekzistuar vetëm "në letër", pa veprimtari reale tregtare. Ky tranzicion, sipas

tyre, do ta destabilizojë furnizimin dhe do të ndikojë në rritjen e çmimeve të produkteve të tjera.

Për këtë arsye, më 21 mars Oda Ekonomike e Kosovës kërkoi nga Avokati i Popullit ta iniciojë këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese dhe të kërkojë pezullimin e vendimit për të paktën një vit.

Avokati i Popullit konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" se e ka pranuar ankesën e Odës Ekonomike të Kosovës dhe është duke e shqyrtuar. "Për Avokatin e Popullit kjo është një situatë komplekse për faktin se këto zhvillime janë bërë në kohën kur institucionet kryesore janë në krijim e sipër", thuhet në përgjigje, ku shtohet se shtrenjtimi i tarifave të rrymës do të ketë pasoja në të drejtat socio-ekonomike për qytetarët. Megjithatë, ZRRE-ja përsëriti se kapacitetet ekzistuese janë të mjaftueshme për t'i furnizuar bizneset me energji pas liberalizimit të tregut. "Shumica e furnizuesve janë duke bërë përgatitjet e nevojshme teknike dhe administrative për të qenë funksionalë në treg", thuhet në një përgjigje që ZRRE-ja i dërgoi "Radios Evropa e Lirë".

ZRRE-ja thotë se është duke zhvilluar takime të rregullta dhe informuese me të gjithë furnizuesit e licencuar me qëllim që të informohen në mënyrë sa më të qartë rreth hapave dhe mundësive që ofron liberalizimi i tregut.

specifike në Gjykatën Kushtetuese. 3. LV-ja të bëjë marrëveshje politike me subjekte parlamentare. As bashkëpunimi me Nismën nuk arrihet pa marrëveshje politike për bashkëqeverisje. 4. Në rast të dështimit të LV-së për të siguruar votat për formimin e qeverisë, opozita do të ketë

shansin e vet, por nuk e ka të garantuar. 5. Koha për lidhshmëri të guximshme e marrëveshje të mëdha politike të guximshme për bashkëqeverisje. Marrëveshjet politike duhen tani apo pas përsëritjes së zgjedhjeve të reja. 6. Një opsion është që partia fituese

LV-së të formojë një qeveri minore, me mbështetjen e disa subjekteve apo deputetëve, me kusht që ata marrin kryetarin e kuvendit. Kjo qeveri duhet të jetë me mandat shumë të kufizuar kohor. 7. Qeveri teknike. Nëse LV-ja, PDK-ja dhe LDK-ja besojnë se blloqet e tyre nuk

mund të formojnë qeverinë, ato duhet të pajtohen për një qeveri teknike (përfshirë programin dhe prioritetet) me mandat deri në shkurt të vitit 2026. 8. Nëse të gjitha këto opsione nuk funksionojnë, subjektet politike duhet të pajtohen për shpalljen e zgjedhjeve të reja sa më

shpejt. 9. Dhe për të gjitha opsionet duhet dialog të nivelit të lartë politik në mes të liderëve. 10. Mungesa e dialogut do të thellojë krizën dhe detyrojë subjektet të bëjnë zgjidhje të rrezikshme për të ardhmen dhe funksionimin e institucioneve", ka thënë Rashiti.

Mbyllen dy lokale në veri për shkelje sanitare

MITROVICË, 29 PRILL - Komuna e Mitrovicës Veriore, me mbështetjen e Inspektoratit Sanitar të Ministrisë së Shëndetësisë, gjatë fundjavës kanë kryer kontrollin e disa

objekteve gastronomike. Sipas një njoftimi të komunës, aktiviteti i dy objekteve u pezullua përkohësisht për shkelje sanitare, ndërsa të tjerët duhet të dorëzojnë dëshmi të

përmbushjes së kushteve. “Inspektorati vazhdon paralelisht lirimin e hapësirave publike, duke përmirësuar rendin urban dhe sigurinë e këmbësorëve. Falënderojmë

qytetarët për bashkëpunimin dhe mbështetjen. Ftojmë shfrytëzuesit e hapësirave publike të pajisen me lejet e nevojshme pranë Drejtorisë së Urbanizmit”, thuhet në njoftim.



BESNIK TAHIRI: GARANCITË JURIDIKE PËR SHËRBIMIN CIVIL, NJË BETEJË QË VAZHDON

PRISHTINË, 29 PRILL - Nënkryetari i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se njoftimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet KO222/24 dhe KO224/24, i cili vlerëson si në përputhje me Kushtetutën dispozitat kalimtare të Ligjit për Zyrarët Publikë (Ligji nr. 08/L-294), që shndërrojnë pozitat e nivelit të mesëm dhe të ulët drejtuese nga pozita me afat të pacaktuar në mandate të kufizuara, është një kthesë e rrezikshme për të ardhmen e shërbimit civil në Kosovë dhe cenim i garancive juridike të tyre. Ai ka thënë se ky zhvillim cenon të drejtat e fituara dhe pritjet legjitime të nëpunësve civilë, dhe bie ndesh me standardet e SIGMA-s për një administratë të qëndrueshme, profesionale dhe të mbrojtur nga ndikimi politik. “Po ashtu, bie ndesh me komentet e përsëritura të Bashkimit Evropian, që kërkojnë nga Kosova depolitizimin e administratës dhe respektimin e

sigurisë juridike të nëpunësve publikë. Në këtë kontekst, bie ndesh me vetë obligimet që ka marrë Kosova me MSA-në për reformimin e administratës shtetërore në koordinim të ngushtë me BE-në. Të gjitha ndërhyrjet në këtë ligj nuk janë të frymëzuara nga parimi i rregullimit të duhur dhe të qëndrueshëm të strukturave shtetërore. Në fakt, ato po krijojnë praktika që mund ta rrezikojnë seriozisht funksionimin institucional të shtetit. Këto ndryshime po ndikojnë në stabilitetin e administratës publike dhe mund ta minojnë besimin e qytetarëve në institucionet që duhet të jenë të qëndrueshme dhe të depolitizuara”, ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se ky vendim është pjesë e një tendence më të gjerë për kontroll institucional, njësoj si në rastin e përpjekjeve të vazhdueshme për të ndikuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës



për Shërbimin Civil, përmes shkarkimeve të anëtarëve, ndërhyrjeve në mandatin e tij dhe cenimit të rolit mbikëqyrës që ai duhet të luajë në mbrojtje të pavarësisë dhe paanshmërisë së shërbimit civil. “Në rolin tim të mëparshëm si Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore,

zëvendëskryeministër e deputet kam pasur gjithmonë një fokus të vetëm dhe të qartë: ruajtjen dhe forcimin e garancive juridike për një administratë të pavarur, profesionale dhe të depolitizuar. Ky ka qenë angazhimi im kryesor për një administratë që respekton standardet ndërkom-

bëtare dhe që vepron në interes të qytetarëve, dhe jo në interes të grupeve politike. Besoj fuqishëm që një shërbim civil i fortë dhe i pavarur është themeli për një shtet të qëndrueshëm, që bazohet në parimet e sundimit të ligjit dhe transparencës”, ka theksuar Tahiri, duke shtuar se: “Edhe pse unë, kam kundërshtuar këtë ndryshim në disa raste, e dimë se pas disa tentativave për kontroll të shërbimit civil, ky vendim është pranuar. Megjithatë, unë do të angazhohem për t’i rikthyer garancitë e plota për shërbimin civil. Do të punoj që ato të sigurohen dhe ta ruajnë administratën tonë të pavarur, moderne, profesionale dhe të depolitizuar. Ky është angazhimi im pra për një administratë të fuqishme dhe të pavarur, pa ndikime të jashtme dhe për mbrojtjen e këtyre garancive të domosdoshme për stabilitetin dhe zhvillimin e Kosovës”.

MBAHET KONFERENCA ‘FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRETNIK NË MEDIET NË KOSOVË’



PRISHTINË, 29 PRILL - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka organizuar të martën konferencën “Fuqizimi i bashkëpunimit ndëretnik në mediet në Kosovë”, ku gazetarë dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave diskutuan mbi rëndësinë e raportimit gjithëpërfshirës dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve etnike në medie. Konferenca përfshiu një panel diskutimi, të moderuar nga Getoarë Mulliqi, drejtoreshë ekzekutive e AGK-së, me pjesëmarrjen e Brikenda Rexhepit, kryetare e Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës - Press Council of Kosovo, Arta

Pllana, koordinatore për komunikim nga Zyra e Komisionarit për Gjuhë dhe Arben Hajredinaj, udhëheqës detyrë i shefit në Seksionin e Medias në OSCE Mission in Kosovo. Gjatë diskutimit u theksua se bashkëpunimi ndërmjet gazetarëve të komuniteteve të ndryshme duhet të bazohet në respekt, profesionalizëm dhe synimin për të ndërtuar një media gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjithë. U përmend rëndësia e komunikimit ndërgjuhësor në gazetari dhe nevoja për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë gazetarët, pa dallim etnie.

Panelistët ndanë përvoja konkrete nga puna e tyre në institucione dhe organizata të ndryshme, duke theksuar se krijimi i hapësirave për bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash në rajon ndihmon në ndërtimin e besimit dhe përmirësimin e raportimit për çështjet ndëretnike. Konferenca shërbeu si platformë e rëndësishme për ndarjen e përvojave, shqetësimeve dhe ideve konkrete për ndërtimin e një mjedisi mediatik më të barabartë dhe bashkëpunues në Kosovë. Ky projekt mbështetet nga UNMIK -u (United Nations Mission in Kosovo).

Në e-Kosova shtohen edhe tetë shërbime të reja në kategorinë “Gjendja Civile”

Prishtinë, 29 prill - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka bërë me dije se platformën e-Kosova e kanë filluar në mandatin e parë qeverisës, me vetëm 1 shërbim, atë për vaksinimin kundër pandemisë Covid-19. “Me përkushtim të pandalshëm sot shënojmë mbi 230 shërbime që

ofrohen online edhe në mobil për iOS dhe Android. ‘E-Kosova’, si dera më e lehtë dhe e shpejtë e marrjes së shërbimeve, numëron mbi një milion përdorues dhe mbi 14 milionë shërbime që janë marrë nga qytetarët tanë të të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Dje kemi shtuar edhe

tetë shërbime të reja në kategorinë ‘Gjendja Civile’, ndërsa me ekipet profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional do ta vijojmë digjitalizimin e shërbimeve të reja, me qëllim të kursimit të kohës e shpenzimeve për qytetarët tanë”, ka thënë Sveçla.



Kurti bëri homazhe në Zhazhë dhe vizitoi Kompleksin e Kullave të Isa Boletinit

ZHAZHË DHE BOLETIN, 29 PRILL - Kryeministri në detyrë Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin e parë, Besnik Bislimi, ministrin në detyrë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, kryetarin e komunës së Mitrovicës Veriore, Erden Atiq dhe deputetë të Kuvendit, kanë bërë homazhe të martën në Zhazhë në kujtim dhe nderim të civilëve shqiptarë të vvarë në masakrën e Zhazhës. 26 vjet më parë forcat policore ekzekutuan civilë shqiptarë të pambrojtur dhe të paarmatosur, në mesin e tyre edhe një të mitur, Fidan Pecin,

i cili ishte vetëm 16 vjeç. Kryeministri Kurti dhe ministri Peci, të shoqëruar edhe nga deputetë të Kuvendit, vendosën lule të freskëta te lapidari i ngritur në nderim të viktimave civile dhe katër dëshmorëve të kësaj zone, të rënë në luftën çlirimtare. Pas homazheve në Zhazhë ata vazhduan për në fshatin Boletin në komunën e Zveçanit, ku vizituan Kompleksin e Kullave të Isa Boletinit dhe vendosën lule të freskëta mbi varrin e heroit Isa Boletini. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nisur dy

programe për këtë kompleks të rëndësishëm për popullin shqiptar, kurimin profesional të ekspozitës së përhershme muzeore dhe funksionalizimin e tij përmes menaxhimit e aktiviteteve të rregullta. Në librin e përshtypjeve, kryeministri Kurti shkroi: “Në Kullat e Isa Boletinit u mësua dhe u mbrojt historia e shqiptarëve, por edhe tek ato u bë historia e u lartësuan shqiptarët. Çdo brez duhet të rikthehet këtu që të mësojë, të mbrojë e të bëjë që të ecë përpara. Lavdi Isa Boletinit dhe luftëtarëve të tij!”.



RAPORTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT: AI PËRMEND LIGJET QË S’I KALOI KUVENDI I KOSOVËS

PRISHTINË, 29 PRILL - Shtypja e mendimeve ndryshe, përshkallëzimet e konflikteve të armatosura, përpjekjet e pamjaftueshme për ta adresuar kolapsin klimatik, si dhe reagimi në rritje në mbarë botën kundër të drejtave të migrantëve, refugjatëve, grave, vajzave dhe personave LGBTI, janë çështje që janë ngritur në raportin vjetor për të drejtat e njeriut të organizatës ndërkombëtare Amnesty International (AI) të publikuar më 29 prill. “Secila prej këtyre çështjeve përballet me përkeqësim të mëtejshëm në një vit të trazuar si 2025, nëse nuk arrihet një kthesë globale”, tha AI. Raporti vjetor i Amnesty International - që tregon se sa po respektohen të drejtat e njeriut nëpër botë - përmendi mosmiratimin e Ligjit për Fertilizimin e Asistuar dhe Shëndetin Riprodhues (IVF) dhe Kodin Civil në Kuvendin e Kosovës. “Qasja në IVF vazhdoi të jetë e qasshme vetëm në klinika private, pas një tjetër tentimi të dështuar në parlament për ta kaluar Ligjin për Shëndetin Riprodhues që do ta mundësonte shërbimin e IVF-it në spitale publike”, thuhet në raportin vjetor të AI. Aty, gjithashtu, thuhet se debati në Kuvend është ndjekur me “dezinformata dhe gjuhë të urrejtjes ndaj grave beqare nga disa deputetë”. “Radio Evropa e Lirë” kishte raportuar për deputetët të cilët e kishin kundërshtuar këtë ligj, duke u thirrur në besimin e tyre se kështu e mbrojnë “familjen si



institucion” dhe se IVF-ja duhet të jetë opsion vetëm për çiftet e martuara heteroseksuale. Të njëjtët deputetë - bashkë me disa të tjerë - kanë kundërshtuar edhe kalimin e Kodit Civil në Kuvendin e Kosovës - i cili, megjithatë, nuk është sjellë për miratim në Kuvend që nga viti 2022. Mospajtimet e deputetëve lidheshin me nenin që do të

mundësonte hartimin e një ligji të posaçëm, përmes të cilit do të lejohej regjistrimi i “bashkësive civile” ndërmjet personave me gjini të njëjtë. Përpos dështimit të kalimit të Kodit Civil, Amnesty International, në raportin vjetor, theksoi se të mbijetuarit e dhunës në familje që i përkasin komunitetit LGBTI+ (lesbikë, gej, biseksual, transgjinerë,

ndërgjinerë etj.) “nuk kanë ende qasje në strehimore të specializuara”. “REL”-i në të kaluarën ka raportuar edhe për këtë problem, që ndër vite ka detyruar të mbijetuarit e dhunës në familje që i përkasin këtij komuniteti të largohen nga Kosova për t’u strehuar në Tiranë të Shqipërisë. Në pjesën për Kosovën të këtij raporti përmendet edhe

dështimi në tentimin e Kosovës për t’u anëtarësuar në Këshillin e Evropës, tentimet për të hetuar dhe gjykuar rastet e krimeve të luftës, miratimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave që, megjithatë, javën e kaluar u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese dhe marrëveshja me Danimarkën për strehimin e të burgosurve në Kosovë.

Buka, qumështi dhe vezët kanë nisur të shtrenjtohen

PRISHTINË, 29 PRILL - Buka, qumështi, vezët e produkte të tjera kanë nisur të shtrenjtohen në Kosovë. Nga 50 centë sa ishte çmimi i bukës, ka shkuar në 70 centë në disa furra, ndërsa çmimi i produkteve të qumështit pritet të ngrihet nga 15-20 %.

Qytetarët po ankohen se edhe çmimet e produkteve të tjera kanë shënuar ngritje. Nga Shoqata e Industrisë së Qumështorëve të Kosovës thonë se ngritja e çmimit po bëhet për shkak të ngritjes së tarifave të energjisë elektrike. Ngritje të çmimeve kanë

paralajmëruar edhe biznese të tjera në Kosovë. Ngritja e çmimeve të produkteve ushqimore dhe shërbimeve është paralajmëruar se do të vijë pas rritjes së tarifave të energjisë elektrike në 16.1 %. Të dhënat e fundit të

Agjencisë së Statistikave të Kosovës flasin për ngritje të çmimeve për 2.9 % në muajin mars krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Ngritje kanë shënuar çmimet e qumështit, djathit, vezëve, kafesë, çajit e perimeve. Kësaj vale të ngritjes së çmimeve së



fundmi i janë bashkuar edhe kafenetë dhe restorantet në Kosovë.

NISIN PUNIMET PËR MODERNIZIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA B

PRISHTINË, 29 PRILL - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, së bashku me ministrin në detyrë të Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka vizituar Termocentralin Kosova B me rastin e fillimit të punimeve në modernizimin e njësishë B2 - investim ky i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Aty u pritën nga ushtruesi i detyrës së kryeshefit të KEK-ut, Gramos Hashani.

Për herë të parë ka filluar riparimi dhe modernizimi në termocentralet ekzistuese të KEK-ut dhe po bëhet një rritje e kapacitetit për njësi, një prodhim vjetor shtesë prej mbi 600 GWh, si dhe një operim më i sigurt dhe më efikas i njësive

të TC Kosova B.

Realizimi i projekteve të rehabilitimit bazohet në studimin e fizibilitetit për TC Kosova B. Ky rehabilitim do të kontribuojë në përmbushjen e kërkesave mjedisore, duke reduktuar ndotjen e ajrit dhe duke siguruar përputhjen me standardet e Direktivave të Bashkimit Evropian (BE) për emisionet e pluhurit dhe gazrave. “Unë ju përgëzoj shumë për këtë modernizim të turbinave në Termocentralin Kosova B, edhe të njësishë B1 edhe B2, të cilat janë të sekuencura në kohë, në mënyrë që ta kemi maksimumin e prodhimit, po në të njëjtën kohë ta



shtojmë edhe prodhimtarinë, edhe sigurinë, edhe efikasitetin e ta ulim ndotjen”, tha kryeministri Kurti gjatë vizitës. Ai në veçanti e uroi menaxhmentin dhe punëtorët

e KEK-ut, që ky investim prej 56.5 milionë eurosh po financohet nga vetë KEK-u, prej të cilit do të kemi shtesë prodhimtari të energjisë prej 600 GWh, gjë që përbën lajm të

mirë për qytetarët, industrinë dhe ekonominë tonë.

Ministria Rizvanolli tha se kur të përfundojnë të gjitha punimet për rehabilitimin e Termocentralit Kosova B, jetëgjatësia e tij do të shtohet edhe për 20 vjet, ndotja nga pluhuri dhe oksidet e azotit do të ulen për 60 %, kurse remontet kapitale do të nevojiten që të bëhen një herë në 10 vjet, në vend se çdo pesë vjet. “Kjo do të thotë se siguria e furnizimit do të përmirësohet dukshëm për 20 vitet e ardhshme, importi do të ulet për së paku 23 milionë euro, ndërkaj eksporti do të rritet për së paku 20 milionë në vit”, shtoi ajo.

FERAT SHALA: KURTI NDAU QYTETARËT E KOSOVËS NË DY TREGJE ENERGJETIKE, KJO ËSHTË E KUNDËRLIGJSHME

PRISHTINË, 29 PRILL - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka reaguar në lidhje me rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Shala ka thënë se Albin Kurti ka ndarë qytetarët e Kosovës në dy tregje energjetike, ku qytetarët në veri të vendit nuk do të preken nga vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për rritjen e rrymës prej 16.1-përqindësh. “ZRRë është institucion i pavarur,



rregullator i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës për ta kryer mandatin në tërë territorin e Kosovës. Andaj ndarja e qytetarëve në kategori e regjione veçanërisht në këtë mandat qeverisës, në theks të veçantë veri dhe jug, është antiligjore, është pabarazi qytetare. Kjo ndodh në qeverisjen e z. Kurti, ku një pjesë e qytetarëve të Republikës së Kosovës janë në treg të rregulluar energjetik

dhe u ngrehet çmimi i energjisë tri herë për katër vjet. Ndërkaj për pjesën tjetër të qytetarëve që janë në treg të derregulluar energjetik, në veri të Kosovës, nuk ka rritje të çmimit të energjisë. Zyrtarisht, z. Kurti, me marrëveshjen për energjinë pas katër vjetësh negociata me ‘Elektrotroserver’-in, i ndau qytetarët e Kosovës në dy tregje të ndryshme energjetike. Pra, thënë thjesht, për qytetarët e

pjesës veriore të Kosovës nuk do të ketë ngritje të tarifave të energjisë siç po ndodh me pjesën tjetër të Kosovës rritja me 16.1%”, ka thënë ai. Shala ka thënë se ky është sovraniteti energjetik i qeverisë Kurti. “Sovranitet të tillë, improvizues popullist ke pothuajse në shumë sektorë të ekonomisë. Nuk është e rastësishme zvarritja e formimit të institucioneve!”, është shprehur Shala.

KURTI DHE RIZVANOLLI VIZITOJNË NDËRTESAT SOCIALE NË MITROVICË

MITROVICË, 29 PRILL - Kryeministri në detyrë Albin Kurti, së bashku me ministrin në detyrë të Ekonomisë, Artane Rizvanolli, vizituan dy ndërtesat sociale në Shipol dhe Desi të Mitrovicës, ku po investohet në rritjen e efikasitetit të energjisë.

Në këto ndërtesa po kryhet izolimi i çatave dhe mureve të jashtme, ndërrimi i dyerve dhe dritareve të vjetruara, instalimi i sistemeve të ngrohjes efikase, vendosja e interfonisë dhe implementimi i masave për mbrojtje nga zjarri.

Këto dy ndërtesa sociale, të ndërtuara në vitet 2003 dhe 2005, strehojnë 39 familje ose gjithsej 173 banorë dhe për

shumë vjet kanë qenë pa izolim të duhur, pa dritare efikase dhe pa sisteme adekuate të ngrohjes.

Falë një investimi prej 381 622 eurosh këto banesa po transformohen dhe punimet pritet të përfundojnë deri në vjeshtë.

Në Shipol ndërtesa sociale e ndërtuar në vitin 2003 do t'i përmirësojë kushtet e jetesës për 18 familje, përfshirë 4 familje të udhëhequra nga gra. Ndërsa në Desi ndërtesa e vitit 2005 do t'u shërbejë 21 familjeve, mes tyre 4 të udhëhequra nga gra.

Ky projekt është pjesë e një investimi më të madh, prej mbi 6 milionë eurosh, që përfshin



renovimin e 25 ndërtesave sociale në gjithë Kosovën. Financimi mbulohet 90 % nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Bashkimi Evropian, ndërsa komunat kontribuojnë 10 %. Projekti zbatohet nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Përveç ndërtesave sociale, në Mitrovicë janë renovuar edhe 9 objekte publike, duke përfshirë: 4 shkolla, 1 çerdhe, 2 ambulanta në Bajgorë dhe Bare, si dhe Qendrën e Kulturës. Këto renovime përmirësojnë ndjeshëm kushtet e jetesës, të edukimit dhe të shërbimeve shëndetësore për mijëra qytetarë.

Kryeministri i Malit të Zi kërkon heqjen e shtetësisë për biznesmenin e Kosovës

PRISHTINË, 29 PRILL - Kryeministri i Malit të Zi, Millojko Spajiq, ka kërkuar nga ministri i Punëve të Brendshme, Danillo Sharanoviq, që urgjentisht ta nisë procedurën për heqjen e shtetësisë për biznesmenin nga Kosova, Naser Ramaj, i akuzuar për evazion fiskal.

Ky lajm është konfirmuar për “Radion Evropa e Lirë” nga

Qeveria e Malit të Zi.

Qeveria e ish-kryeministrit Dritan Abazoviq ia kishte dhënë Ramajt shtetësinë e nderit në vitin 2023, me arsyetimin se ai ishte një nga investitorët e kompleksit “Porto Budva” me vlerë prej 80 milionë eurosh.

Prokuroria e akuzon atë dhe Valentinë Gruboviqin se, si përgjegjës në kompaninë

“Alart Centar Budva”, nuk kanë raportuar të ardhurat nga shitja e hapësirave të banimit dhe biznesit pikërisht në këtë kompleks.

Prokuroria njoftoi para tre ditësh se Gjykata Themelore në Kotor kishte konfirmuar aktakuzën. “Dhënia e shtetësisë një personi që është nën hetim për shmangie taksash dhe mashtrime

financiare mund ta dëmtojë reputacionin ndërkombëtar të Malit të Zi, veçanërisht në sytë e partnerëve nga Bashkimi Evropian, gjë që mund të ndikojë negativisht në investimet e ardhshme dhe në pozicionin negociues në procesin e integritetit evropian”, theksoi Spajiq në një shkresë dërguar ministrit të policisë.



REKORD I RI I SHPENZIMEVE USHTARAKE NË BOTË: GJERMANIA NGJITET NË VENDIN E 4-T, ASNJË VEND NUK SHPENZON MË SHUMË SE SHBA



Shpenzimet ushtarake globale arritën një nivel të ri në vitin 2024. Gjermania ngjitet në vendin e katërt në rangun botëror të shpenzimeve për mbrojtjen.

Rreth 2,7 bilionë dollarë – ky është rekordi i ri financiar botëror për shpenzimet ushtarake në vitin e kaluar – një rritje prej 9,4% krahasuar me vitin 2023. Ka dhjetë vjet që shpenzimet ushtarake në botë po rriten. Por asnjëherë kaq shumë që fundi i Luftës së Ftohtë. Më shumë se 100 vende kanë shpenzuar më shumë për ushtrinë se vitin e kaluar. Rritje e ndjeshme e shpenzimeve ushtarake vihet re në Evropë dhe Lindjen e Mesme, pasojë e luftës në Ukrainë dhe në Gaza, sipas Institutit të Stokholmit për Studimet e Paqes, SIPRI.

Gjermania ngjitet në vendin e 4-t

Tek ky zhvillim në Europë ka luajtur mjaft rol edhe Gjermania: në vitin 2024, shpenzimet ushtarake gjermane u rritën për të tretin

vit radhazi. Sipas SIPRI, ato arritën në 88.5 miliardë dollarë amerikanë, që ishte 28 për qind më shumë se një vit më parë. Kjo e vendos Gjermaninë në vendin e katërt në renditjen e vendeve me shpenzimet më të larta ushtarake – pas SHBA-së, Kinës dhe Rusisë. Në vitin 2023, Gjermania ishte ende në vendin e shtatë.

“Për herë të parë që nga ribashkimi, Gjermania është vendi me shpenzimet më të larta ushtarake në Evropën Perëndimore”, thekson studiuesi i SIPRI, Lorenzo Scarazzato. Kjo për shkak të fondit të veçantë prej 100 miliardë eurosh për Bundeswehr-in, i miratuar në vitin 2022. Me këto para, Gjermania do të pajisë më mirë ushtrinë e saj me mungesa të mëdha.

Sipas SIPRI, ky nuk është fundi: “Vendimet e fundit politike në Gjermani dhe shumë vende të tjera evropiane tregojnë se Evropa ka hyrë në një fazë të shpenzimeve të larta dhe në rritje ushtarake, e cila ka të ngjarë të vazhdojë në një të ardhme të parashikueshme.”

Ukraina me barrën më të madhe ushtarake

Edhe vende të tjera evropiane i rritën ndjeshëm shpenzimet e tyre ushtarake në vitin 2024: Polonia shpenzoi 31 për qind më shumë se një vit më parë dhe tani investon 4.2 për qind të prodhimit të saj të brendshëm bruto në mbrojtje. Kjo është vlere më e lartë e të gjithë anëtarëve evropianë të NATO-s. Në vitin 2024, vit kur u bashkua me NATO-n, Suedia investoi 34 për qind më shumë se një vit më parë, duke shpenzuar dymbëdhjetë miliardë dollarë amerikanë për mbrojtjen.

Por Ukraina mban barrën më të madhe ushtarake në botë: shpenzimet e saj ushtarake arritën në 34 përqind të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2024. Për krahasim në Gjermani vitin e kaluar ishin rreth dy përqind. “Të gjitha të ardhurat nga tatimet në Ukrainë u absorbuan plotësisht nga shpenzimet ushtarake në vitin 2024, ndërsa të gjitha shpenzimet joushtarake socio-ekonomike


u financuan nga ndihma e huaj”, thuhet në raportin e SIPRI. Kurse Rusia agresore investoi 149 miliardë dollarë në forcat e saj të armatosura vitin e kaluar, një rritje prej 38 për qind në krahasim me vitin 2023.

Asnjë vend nuk shpenzon më shumë se SHBA

Shtetet e Bashkuara mbeten deri tani vendi me shpenzimet më të larta ushtarake, të cilat u rritën edhe më tej në vitin 2024. Ky shtet investoi gjithsej 997 miliardë dollarë amerikanë në forcat e armatosura. “Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të SHBA-së për vitin 2024 u caktua për modernizimin e aftësive ushtarake të SHBA-së dhe arsenalit bërthamor të SHBA-së për të ruajtur një avantazh strategjik ndaj Rusisë dhe Kinës”, sipas analizës së SIPRI. SHBA ka më shumë se 5000 koka bërthamore dhe po investon shumë në modernizimin gradual të arsenalit të saj.

Edhe Kina e vazhdoi kursin e

modernizimit të ushtrisë së saj në të gjitha fushat, plan që parashikohet të zgjasë deri në vitin 2035 – me një buxhet prej 314 miliardë dollarësh në vitin 2024. Sipas SIPRI, aftësitë e përmirësuara ushtarake përfshijnë “avionë të rinj luftarakë të maskuar, mjete ajrore pa pilot (UAV) dhe mjete nënujore pa pilot”. Përveç kësaj, Kina zgjeroi me shpejtësi arsenalin e saj bërthamor në vitin 2024. Në lindje bie në sy për shpenzimet ushtarake edhe Japonia, që i rriti shpenzimet ushtarake me 21% në 55,3 miliardë dollarë vitin e kaluar. Në Lindjen e Mesme spikat Izraeli, që i rriti shpenzimet ushtarake me 65 për qind në 46.5 miliardë dollarë në vitin 2024. Arsyeja për këtë lidhet me përshkallëzimin e konfliktit me Hezbollahun dhe vazhdimi i luftës në Rripin e Gazës. Në këtë sfond, edhe Libani gjithashtu shpenzoi dukshëm më shumë për mbrojtjen. Për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe ekonomike të vendit, kjo nuk kishte ndodhur në vitet e mëparshme./DW



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ndërroi jetë ish-kryetari i KH Trepça, Zeki Loxha

Ka ndërruar jetë Zeki Loxha, ish-kryetar i Klubit të Hendbollit Trepça. I ndjeri e drejtoi klubin mitrovicas në periudhën më të

lavdishme të tij, kur “xehetarët” u inkadruan në ligën e parë federative dhe luajtën në atë ligë. Loxha ishte kryetar i klubit

mitrovicas nga viti 1979 e deri në vitin 1981. Zeki Loxha ka mbajtur pozita të rëndësishme në Kombinatin

Trepça, ndërsa për shumë vjet jetoi në Shqipëri. Presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Edin

Kolgeci, në emër të komunitetit të hendbollit të Kosovës, i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së nderuar Loxha.

‘Ylli i javës’, Thaqi: Shpresojmë të dalim në Evropë

“Epoka e re”

GJILAN, 29 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e 31-të në elitën e futbollit i është dhënë futbollistit të SC Gjilanit, Armend Thaqit. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje të Enver Prapashticës, Enes Shoshollit dhe Avni Shalës. Ky komision vendosi që çmimi “Ylli i javës” për xhiron e tredhjet e një t’i takojë Armend Thaqit, i cili ishte më i dalluari me dy asistime, në fitoren 3:0 të Gjilanit në ndeshjen kundër FC Suharekës. Pasi mori këtë çmim, Thaqi u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: “Është e rëndësishme që kemi fituar tri pikë, sepse nuk ishim në një pozitë të mirë në tabelë dhe kemi pasur një histori shumë negative javët e fundit. Kemi bërë shumë gabime dhe është normale që na duheshin tri pikë për t’u qetësuar dhe për të dalë nga zona e rrezikshmërisë. Kemi thënë që nuk jemi për atë zonë, mirëpo kur humb ndeshjet njëra pas tjetrës, është e qartë që rrezikohesh dhe



e fut veten në atë zonë. Megjithatë, me këto tri pikë të fituara u qetësua sadopak dhe jemi disi më të qetë për ndeshjen e ardhshme, në mënyrë që të vazhdojmë me të njëjtin ritëm”. “Shpresojmë të dalim në Evropë, sepse ende na e lejon matematika. Përveç performancës sonë, duhet të presim

edhe ndonjë gabim nga kundërshtarët tanë, dhe kjo do të ishte një arritje shumë e madhe. Ky çmim i takon gjithë ekipit, jo vetëm mua, sepse të gjithë kanë meritë për këtë paraqitje time. Këtë ndeshje e kemi fituar me shumë meritë”, ka deklaruar Thaqi për faqen zyrtare të FFK-së.

Sonte ‘beteja’ e katërt në mes të Prishtinës dhe Trepçës

Prishtinë, 29 prill - Gjysmëfinalët e “play-off”-it të ProCredit Superligës vazhdojnë me superndeshje këtë mesjavë. Garat shtesë kanë dhuruar emocione dhe adrenalinë. Mesjava sjell sfidat e katërta gjysmëfinale, që janë shumë të rëndësishme. Skuadra që shënon tri fitore kualifikohet në finale. Të gjitha ndeshjet gjysmëfinale janë fituar deri më tani nga vendësit. Në kryeqytet ndeshen Sigal Prishtina me Trepçën, në një tjetër sfidë që pritet të jetë shumë interesante. Prishtinasit synojnë fitoren dhe ta barazojnë serinë në 2:2, kurse mitrovicasit të fitojnë dhe të kualifikohen për herë të katërt radhazi në finale. Takimin e parë e fituan



mitrovicasit 80:65, të dytin e fituan prishtinasit pas vazhdimeve 90:83, ndërsa të tretin mitrovicasit 67:61. Gjysmëfinalja tjetër është shumë interesante ndërmjet Pejës dhe

Bashkimit. Prizrenasit po udhëheqin 2:1 në serinë gjysmëfinale dhe synojnë fitoren për t’u kualifikuar në finale, ndërsa pejanët ta barazojnë serinë në 2:2, në mënyrë që finalisti të përcaktohet në sfidën e pestë. “Portokallezinjtë” fituan ndeshjen e parë 81:61 dhe të tretën 84:78 pas vazhdimeve, kurse pejanët fituan ndeshjen e dytë 84:79.

GJYSMËFINALET IV

Të mërkurën takohen:
19:00 Sigal Prishtina - Trepça

Të enjten takohen:
19:00 Peja - Bashkimi

SHKURT

Albert Sylejmani pranohet në Programin FECC

Trajneri Albert Sylejmani është pranuar në Programin FECC (FIBA Europe Coaching Certificate). Sylejmani ishte propozuar nga Federata e Basketbollit e Kosovës. Ai do të jetë pjesë e Programit 2025-27, thuhet në letrën e pranimit. Në programin FECC së fundi ishte pranuar Driton Obërtinca, derisa janë certifikuar më herët Valentin Spaqi, Gyltekin Selimi, Dritëro Sefaja, Edon Godeni, Petrit Zeqiri dhe Ilir Selmani, të cilët ishin nominuar nga FBK-ja. Ky është edicioni i nëntë i këtij programi që në fokus ka trajnerët/et që punojnë me gjenerata të reja. Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) me anë të edukimit të trajnerëve në Programe të Rëndësishme Ndërkombëtare dëshmon për rëndësinë dhe përkushtimin që u jep gjeneratave të reja, duke synuar nxjerrjen e talenteve dhe masivizimin e basketbollit.

Gjimshiti në formacionin e javës në Serisë A

Berat Gjimshiti është bërë pjesë e formacionit të javës së 34-t në Serinë A. Kapiteni i Kombëtares u aktivizua titullar me Atalantën në barazimin 1-1 kundër Lecces. Mburojtësi u vlerësua me notën 8.0, duke bërë një paraqitje të mirë me bergamaskët. Formacioni më i mirë i kësaj është i përbërë pothuajse nga të gjitha skuadrat (Como, Lazio, Roma, Parma, Napoli, Roma, Inter, Bologna, Cagliari) teksa nga Atalanta është pjesë edhe Retegui. Formacioni: Caprile, Augusto, Gjimshiti, Miranda, Soule, McTominay, Ondrejka, Angelino, Pedro, Retegui, Strefezza.

Asllani, afër transferimit në Lazio

Kristjan Asllani pritet të largohet nga skuadra e Interit këtë verë, por jo edhe nga Seria A. Mediumet italiane kanë

raportuar të martën se Asllani, sipas të gjitha, gjasave do t’i bashkohet Lazios, ndonëse interesim për të ka shprehur skuadra

e Bolognas. Thuhet se Interi po synon transferimin e mesfushorit të Lazios, Matteo Guendouzi, kartoni i të

cilit kushton 35 milionë euro. Mirëpo, Interi ka ofruar kartonin e Asllanit dhe 20 milionë euro për francezin, të cilin po e

sheh si përforcim të duhur për mesfushën. Në anën tjetër, Asllani pëlqehet nga trajneri i Lazios, Marco BarONIO.

Rahoveci bie nga Liga e Parë, Leci jep dorëheqje

RAHOVEC, 29 PRILL - Rahoveci me një këmbë është në Ligën e Dytë të futbollit. Për shkak të rezultateve jo të mira, kjo skuadër nuk mundi të mbijetojë, duke ngelur e parafundit me vetëm 17 pikë, dhjetë më pak se Istogu që ka

shpëtuar. Kryetrajneri i këtij ekipi, Liridon Leci, ka dhënë dorëheqje, pasi dështoi t'i marrë 3 pikë ndaj Rilindjes, rezultat me të cilin të paktën matematikisht do të ishte ende në garë. Lajmin për ndarjen e rrugëve me

timonierin e dha klubi i Anadrinisë me anë të një komunikate në faqen zyrtare në "Facebook". "Në javët e mbetura të sezonit Rahoveci do të zhvillojë edhe tri xhiro të fundit të kampionatit me staf të përkohshëm, ndërkohë që drejtuesit e

klubit kanë paralajmëruar riorganizim të plotë për sezonin e ardhshëm, me synim rikthimin e shpejtë në Ligën e Parë", thuhet në njoftim. Gjatë gjithë edicionit 2024/25 Rahoveci arriti vetëm tri herë të fitojë, tetë



ndeshje përfunduan me barazim, kurse u mposht plot 13 herë.

Shumë dekada në hendboll, Istref Sadriu tërhiqet në fund të edicionit

PRISHTINË, 29 PRILL - Gjatë Final 4 të Kupës së Kosovës në hendboll, që në fundjavë u mbajt në Ferizaj, Federata e Hendbollit e Kosovës ka nderuar me pllakate falënderimi Istref Sadriun, që ka dhënë kontribut për gati pesë dekada në hendbollin e Kosovës. Pllakatën Sadriu ia dorëzoi Muhamet Arifi, sekretar i përgjithshëm i Federatës së Hendbollit të Kosovës. Sadriu do ta kryejë detyrën e vëzhgues-kontrolluesit të ndeshjeve vetëm deri në fund të këtij edicioni. Ai tërhiqet, duke lënë prapa periudhën prej shumë dekadash në shërbim të hendbollit në vendin tonë. Sadriu shquhet për afërsinë me të gjithë njerëzit e hendbollit, ndërsa ka kryer me përgjegjësi të gjitha detyrat që i janë caktuar.

Istref Sadriu karrierën sportive e kishte nisur si shahist. Si pionier kishte përfaqësuar Kosovën në kampionatin e ish-Jugosllavisë. Ishte paraqitur në Pulë të Kroacisë si 15-vjeçar. Më pas luajti futboll për dy vjet te Kosova e Vushtrrisë si junior. U tërhoq për shkak të lëndimeve, ndërsa pasi pauzoi një vit, me ftesë të



kryesisë së KH Samadrexhës, nisi karrierën në hendboll. Me Samadrexhën u bënë kampionë të Kosovës dhe u inkadruan në Ligën e Dytë Federative. Te Samadrexha qëndroi shtatë vjet. Më pas kaloi te Kosova e Vushtrrisë, me ftesë të kryesisë së këtij klubi. Pas një edicioni

garues sërish u bë kampion i Kosovës dhe kaloi në ligën e dytë federative. Te Kosova e Vushtrrisë qëndroi deri në vitin 1989, kur kjo skuadër u tërhoq nga garat. Me ftesë të ikonës Beqir Buqinca, kaloi te Borci i Ferizajt në vitin 1990 dhe për skuadrën e famshme luajti deri kur sportistët tanë u larguan me dhunë nga palestirat dhe objektet sportive. Pas luftës, Sadriu e riaktivizoi klubin Kosova e Vushtrrisë, ndërsa ishte i angazhuar si trajner. Por për shkak të angazhimeve në vendin e punës u tërhoq nga zeja e trajnerit. Nisi karrierën si gjyqtar i hendbollit, ndërsa drejtësinë e ka ndarë nga viti 2001 deri në vitin 2007. Pasi u zgjodh kryetar i Shoqatës së Gjyqtarëve u tërhoq nga referimi dhe prej vitit 2007 u angazhua si vëzhgues. Tetë vjet ishte kryetar i Shoqatës së Gjyqtarëve, katër vjet të tjera komisar e prej vitit 2023 sërish si vëzhgues-kontrollues i ndeshjeve. Federata e Hendbollit e Kosovës e falënderon Istref Sadriun për kontributin e dhënë, ndërsa i dëshiron shëndet dhe çdo të mirë në jetë.

Clevelandi kalon tutje, Miami përjetoi tronditjen më të madhe në historinë e NBA-s

OHIO, 29 PRILL - Janë luajtur dy ndeshje të "play-off"-it të NBA-s dhe, pas tyre, mësuam çerekfinalistin e dytë në ekipin e Cleveland Cavaliersit, i cili tronditi Miami Heatin në seri duke e mposhtur 4-0. Clevelandi i mundi rivalët me rezultat të thellë 138:83, që është një diferencë e pabesueshme prej 55 pikësh. Përndryshe, Clevelandi ishte dominues në çdo ndeshje. Seria nisi me një triumf prej 21 pikësh, në duelin e dytë pati "vetëm" nëntë, në të tretin 37, dhe mbrëmë bëri histori me ndeshjen e katërt. Diferenca totale gjatë gjithë serisë ishte 122 pikë dhe është seria më bindëse në historinë e "play-off"-eve të NBA-s.



s. Rekordi i mëparshëm mbahej nga lakersat në vitin 1986 kur e përfunduan serinë me një diferencë prej +109 pikësh në katër ndeshje. Mitchell me 22 pikë dhe Hunter me 19 pikë udhëhoqën Clevelandin, ndërsa

Joviqi me fanellën e Miamit luajti ndeshjen e sezonit me 24 pikë të shënuara. Shumë më emocionuese ishte ndeshja midis Golden State Warriorsit dhe Houston Rocketsit, ku vendasit festuan pas dramës me rezultatin 109:106 dhe kështu morën epërsinë 3-1 në seri. Mysafirët madje kryesuan në pjesën e parë, por periudha e tretë brilante e Golden States ishte vendimtare, në të cilën e përmbysi avantazhin dhe arriti ta ruajnë atë deri në fund. Butleri me 27 dhe Podziemski me 26 pikë ishin më të mirët në radhët e Golden States, ndërsa Houstoni nuk u ndihmua nga loja e shkëlqyer e Sengunit i cili kishte 31 pikë dhe 10 kërcime.

SHKURT

Hysaj humbet gjyqin me Napolin, dënohet 40 mijë euro

Pas pesë vjetësh e gjysmë dhe tri shkallësh gjyqësore, Gjykata e Lartë italiane (Cassazione) ka vendosur përfundimisht për braktisjen e grumbullimit më 5 nëntor 2019 në ekipin e Napolit, duke dënuar mbrojtësin Elseid Hysaj – aktualisht pjesë e Lazios – me një gjobë prej 40 mijë eurosh, si dhe detyrimin për t'i paguar shpenzimet gjyqësore. Lajmi është dhënë nga "Corriere dello Sport", që shkruan se Cassazione ka konfirmuar se futbollistët nuk kishin të drejtë ta braktisnin grumbullimin e detyruar të vendosur nga klubi pas barazimit kundër Salzburgut në Ligën e Kampionëve. Ky vendim i klubit u kundërshtua nga disa prej liderëve të skuadrës në atë kohë, si Lorenzo Insigne dhe Dries Mertens, të cilët bashkë me lojtarë të tjerë u përballën me masa disiplinore nga klubi. Pas vendimit të Kolegjit Arbitral në nëntor 2021, shumica e lojtarëve gjetën marrëveshje me Napolin. I vetmi që vijoi betejën ligjore ishte Hysaj, i cili e çoi çështjen fillimisht në Gjykatën e Napolit dhe më pas në Cassazione, por përfundimisht drejtësia i dha të drejtë klubit.

Te Mercedesi për startin e sezonit: Më mirë sa prisnim

Gara e fundit e Formulës 1 zhvilluar në pistën e Jedah nuk ishte fort e mirë për Mercedesin, por makina britanike ka bërë një paraqitje të mirë në këtë fillimsezon. Me 111 pikë në total, makina gjermane renditet e dyta në botërorin për konstruktorë. Deri më tani, pilotët George Russell dhe Kimi Antonelli kanë qenë gjithnjë mes më të mirëve, sidomos britaniku, që është renditur në "top-5". Këtë fakt e konfirmon edhe shefi i Mercedesit, Toto Wolff, që ka thënë: "Kemi pasur një fillim të mirë të sezonit, por nuk kemi ndjenjën e vetëkënaqësisë". "Nuk e prisnim këtë start. Duam të vazhdojmë në këtë trajektore pozitive që kemi pasur në pesë garat e para. Arabia Saudite ishte një Çmimi i Madh më kërkues, por mësuam shumë prej tij. Kështu që shpresojmë për një rezultat më të mirë në Miami", ka deklaruar menaxheri austriak.

Ancelotti arrin marrëveshje me Brazilin

Trajneri aktual i Real Madridit, Carlo Ancelotti, me shumë mundësi do të emërohet trajner i Kombëtares së Brazilit. Eksperti i transferimeve, Fabrizio Romano, ka njoftuar të hënën mbrëma që është arritur marrëveshja në parim mes Ancelottit dhe federatës braziliane të futbollit. Marrëveshja mund të jetë e vlefshme nga qershori dhe jo pas Botërorit të klubeve. Ancelotti pritet të ndahet me Real Madridin, por ndarja pritet të jetë miqësore duke respektuar të dyja palët. Ancelotti ka shkruar histori me madrilenët, duke u bërë trajneri me më së shumti trofe në histori të klubit.

Salah: Ky titull kampion është më i bukur se ai që fituam me Kloppin

Sulmuesi i Liverpoolit, Mohamed Salah, beson se titulli i Premier Ligës fituar këtë sezon është shumë më i bukur se ai i fituar nën drejtimin e Jurgen Kloppit në vitin 2020. Salah shënoi në fitoren shkatërruese 5-

1 të Liverpoolit ndaj Tottenhamit në "Anfield" për ta siguruar titullin me katër ndeshje të mbetura për skuadrën e Arne Slot. Egjiptianit iu kërkua ta krahasonte titullin e këtij sezoni me atë nën drejtimin e Kloppit

fituar në kohën e pandemisë. "Ky është shumë më mirë, jam 100 % i bindur për këtë", ka thënë Salah për "Sky Sports". "Të fitosh titullin pa Mane, pa Jurgen, pa Firmino dhe pa gjithë të tjerët ndihet më e veçantë. Tani kemi

një grup tjetër, trajner tjetër, kështu që të jemi në gjendje ta bëjmë përsëri është diçka e veçantë", ka shtuar Salah. I pyetur nëse Sloti e kishte bërë atë një lojtar më të mirë, Salah bëri shaka: "Mund t'i shihni shifrat, të

paktën duket kështu". "Ai ishte shumë i singertë me mua. Sloti është mjaft i ashpër, kjo duket te personaliteti i tij, por ai na e bëri jetën më të lehtë sepse e dinte menjëherë se çfarë do të bëje, gjë që ne bëjmë", ka deklaruar Salah.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Punesohuni” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811391333 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Punesohuni” D.O.O. Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811391333 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Punesohuni” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811391333 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Autoshkolla ARGJ ABC” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811998337 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Autoshkolla ARGJ ABC” D.O.O. Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811998337 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Autoshkolla ARGJ ABC” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 811998337 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Andi 02” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812266858 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Andi 02” D.O.O. Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812266858 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Andi 02” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 812266858 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ali Brahimi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Bajram Sadrija” Berjah Gjakovë nga kl. 1-8.

- D.P.T. “Rina-R” nga Gajkova shpall të pavlefshme nr. E biznesit 810012831 të lëshuar nga MTI Kosovë.

- Erona Feraj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m.e. Kadri Kusari” Gjakovë.

- NTP Sky shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me nr. 330108622.

- Nevzat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale “Bahri Haxha”-ish shkolla e mesme “Muharrem Bekteshi”.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjel-lëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma,
- kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 46 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 571 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Përkthyes (Shqip – Serbisht dhe anasjelltas)
Numri i referencës:	PSA/ZKA/09-04/25
Grada:	ZKA-X6
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit në përcaktimin e objektivave dhe hartimin e planeve të punës;
- Bën përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë.
- Bënë përkthimin simultan në takime pune, punëtori, konferenca, trajnime dhe në raste të tjera sipas nevojave të ZKA-së;
- Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim të qartë dhe sipas normave gramatikore dhe të sintaksës;
- Mban bazën e të dhënave dhe informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të të gjitha dokumenteve.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet çertifikatë/licencën në përkthim të gjuhës serbe.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve;
- Njohuri në terminologjinë e fushës së auditimit, kontabilitetit dhe financave;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 15.05.2025 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i članovima 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije, vezano sa članom 46 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji radnih mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2025. godinu i Odluke Generalne revizorke br. 571 za popunjavanje slobodnog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS
za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Položaj:	Prevodilac (Albansko- Srpski i obrnuto)
Broj reference:	PSA/ZKA/09-04/25
Nivo:	ZKA-X6
Broj radnih mesta:	Jedno (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže vođi odeljenja u postavljanju ciljeva i izradi planova rada;
- Vrši prevod dokumenata sa albanskog na srpski i obrnuto prema normi utvrđenoj za radni dan. Prosečna norma za prevođenje dokumenata u toku radnog dana obuhvata u proseku 2000 reči.
- Vrši simultano prevođenje na radnim sastancima, radionicama, konferencijama, obukama i u drugim slučajevima prema potrebama NKR-a;
- Pomaže u definisanju i usaglašavanju terminologije, za prevedene dokumente i dokumente, kao i njihovu tačnost sa jasnim značenjem i u skladu sa normama gramatike i sintakse;
- Održava bazu podataka i informacije u vezi sa prevodom svih dokumenata.

Opšti formalni zahtevi za ovu radnu poziciju su:

- Obrazovanje: Diploma fakulteta društvenih nauka;
- Profesionalno iskustvo: Tri (3) godine stručnog radnog iskustva;
- Poželjno je sertifikat/licenca za prevod na srpski jezik.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti prevoda;
- Poznavanje terminologije u oblasti revizije, računovodstva i finansija;
- Veština u komunikaciji i planiranja rada;
- Sposobnost izvršavanja zadataka i poslova pod pritiskom;
- Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Internet).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovana;
- dokazi o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom (ne starija od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na sajtu Nacionalne Kancelarije Revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je 15.05.2025 do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. “Ahmet Krasniqi” br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A.PEJË

NR. 1053

DATA 28.04.25

Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 30.04.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Menaxheri Operativ - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës 3.7

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Organizon, mbikëqyr punën dhe gjenden në deponinë sanitare, pranon sygjerrime dhe japë rekomandime përgjegjësit të deponisë në lidhje me mënyrën e trajtimit të deponisë, duke respektuar standardet e kërkuara. Mban evidencë për sasinë e mbeturinave të deponuara, shpenzimet e karburanteve dhe sasinë e transportuar veç e veç për secilin automjet, si dhe bën analiza mujore për arsyeshmërinë shpenzimeve;
- Është përgjegjës për hartimin e planit strategjik të mirëmbajtjes obligative, mirëmbajtjes si pasojë e prishjes dhe asaj preventive të automjeteve dhe funksionimit optimal të tyre, duke përfshirë stokun me pjesë dhe pajisje rezervë që kërkojnë intervenime më të shpeshta. Po ashtu, duke u bazuar në sigurinë e qarkullimit, është përgjegjës për rregullsinë teknike të automjeteve, pastërtinë e tyre, funksionimin dhe itineraret e sigurta dhe pa humbje të gjata kohore, si dhe regjistrimin e automjeteve, respektivisht kontrollimin periodik të automjeteve. Ndërmerr hapa konkret në zbatueshmërinë e sygjerrimeve nga K.E dhe informon në baza ditore K.E për mbarëvajtjen e operativës.
- Kontrollon dhe miraton furnizimet-shpenzimet e krijuara në punëtori, duke kërkuar raporte ditore-javore dhe mujore nga kryepunëtori i punëtorisë dhe shefi i servisit, si dhe mban evidencë të pjesëve dhe pajisjeve rezervë në baza mujore për funksionimin optimal të punëtorisë;
- Me ndihmën e kryepunëtorëve konkret si dhe rekomandimet e organit përgjegjës të K.K. Pejë, harton Planin Operativ ditor, javor dhe mujor për kryerjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave. Përzgjedh ekipet e caktuara të cilat do ta respektojnë orarin e punës, orët shtesë dhe itinerarin e kryerjes se shërbimeve. Sigurohet që të gjitha shërbimet ne lidhje me mbeturinat të jenë sa më kualitative;
- Koordinon punët në larjet dhe fshirjet e rrugëve dhe trotuareve të qytetit të Pejës, të gjitha këto i bënë në bashkëpunim me kryepunëtorin dhe mbikëqyrësin e caktuar nga K.K. Pejë, në bashkëpunim me kryepunëtorin përgaditën raporte mujore për punët e kryera;
- Të gjitha këto punë i kryen bashkë me ndihmësin-asistentin e njësisë;
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV ;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Diplomë Universitare të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike;
- Shkathtësi komunikuese dhe aftësi organizative të punës;
- Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.);
- Njohja e gjuhëve të huaja do të jetë përparësi;
- Përvoja e punës së paku 5 (pesë) vite menaxheriale profesionale, e dëshmuar.

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 30.04.2025 deri me 15.05.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

Prokurorja Gjenerale	Prokurorja e Përgjithshme	Prokurorja e Përgjithshme	Prokurorja e Përgjithshme
07/3	12	615	1



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 27.03.2025, për vendin e punës:

I. Pozita: Lektor
Numri i pozitave: Një (1)
Numri i referencës: LZKA/ZKA/07-03/25

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin 613 të datës 29.04.2025

Prishtinë, 29.04.2025 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije objavljuje otkazivanje konkursa raspisanog u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 27.03.2025. godine, za radno mesto:

I. Pozicija: Lektor
Broj pozicija: Jedna (1)
Referentni broj: LZKA/ZKA/07-03/25

Konkurs se otkazuje na osnovu Odluke 613 od 29.04.2025

Priština, 29.04.2025 Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima



Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality

★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality

★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality

★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality

★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality

★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales

★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality

★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality

★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality

★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1900